



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 175/1 Prot.

Vlorë, më , 28.01.2021

VENDIM
NR.1, DATË 28.01. 2021

PËR

**MIRATIMIN E FORMËS SË ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE TË SEZONIT VJESHTË,
VITI AKADEMIK 2020-2021**

Duke u bazuar në Nenin 3 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në mbështetje të Ligjit Nr.15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", referuar situatës së krijuar dhe në zbatim të protokolleve shëndetësore anti Covid-19, në mbledhjen e datës 28.01.2021, Rektorati

VENDOSI

1. Provimet e sezonit vjeshtë 2021, për vitin akademik 2020-2021, në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve, do të zhvillohen sipas kalendarit të miratuar nga Rektorati, respektivisht, për Ciklin e Parë në periudhën 15 Shkurt-12 Mars 2021 dhe për Ciklin e Dytë ne periudhen 01Mars-19 Mars 2021.
2. Provimet do të zhvillohen në dy forma: me prezencë fizike të studentëve në auditor dhe online.
3. Departamentet e çdo fakulteti të përcaktojnë listën e lëndëve që do ta zhvillojnë provimin në auditor, me shpjegimet përkatëse se përse këto provime duhet të zhvillohen në auditor. Për provimet që do të realizohen online departamentet të përcaktojnë formën e zhvillimit të provimit (me shkrim apo me gojë).
4. Lista e lëndëve të provimeve që do të zhvillohen në auditor të dorëzohet në formë shkresore dhe elektronike në Rektorat, brenda datës 29 janar 2021, ora 15.00.
5. Provimet e mbartura të sezonit të dimrit 2021 shtyhen në datat 15 Mars-30 Mars 2021.

REKTORI

Prof.Dr.Roland ZISI

